

**MBI AKTIVITETIN  
E KOMISIONIT TË POSAÇËM  
PARLAMENTAR  
DHE ZHVILLIMET NË REFORMËN  
PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN  
DHE SUNDIMIN E LIGJIT**



**KPP – Buletin periodik 04  
Shtator 2024**



**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR  
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,  
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN  
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

## Dokumenti Analitik, ekspertët e nëngrupeve vijnë takimet

Gjatë muajit shtator 2024, Komisioni i Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian” vijoi punën për hartimin e Dokumentit Analitik/ Analizës, dokument që po hartohet nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë.

Fokusi kryesor gjatë muajit shtator kanë qenë takimet e nëngrupeve të ekspertëve të ndarë sipas tre shtyllave objekt pune i Komisionit të Posaçëm: i) *mirëqeverisja*; ii) *antikorrupsioni*; iii) *sundimi i ligjit* për procesin e identifikimit të gjetjeve në funksion të hartimit të Dokumentit analitik sipas komponentëve përkatës.

Ekspertët kanë zhvilluar disa takime, ku kanë punuar së bashku në tavolinën e punës për të diskutuar rreth gjetjeve të tyre dhe kanë përgatitur analizat e para për çdo komponent, për t'i harmonizuar më pas brenda shtyllës përkatëse.

## Finalizimi i metodologjisë për koordinimin e asistencës ndërkombëtare

Gjatë muajit shtator, Komisioni i Posaçëm Parlamentar (KPP) së bashku me drejtuesit e nëngrupeve të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) dhe Sekretariatit Teknik sipas shtyllave ka punuar edhe për të finalizuar metodologjinë për koordinimin e asistencës ndërkombëtare dhe veçanërisht për mënyrën e angazhimit të konsulentëve të jashtëm, me qëllim përfitimin sa më mirë të ekspertizës së tyre profesionale.

## Transparenca e KPP. Drejt përfundimit platforma e komunikimit publik dhe faqja Web

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është punuar për platformën e komunikimit publik dedikuar punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar, që do të mundësojë transparencën e plotë të punës, për të dokumentuar të gjithë veprimtarinë, vendimet dhe dokumentet që do të prodhohen përgjatë mandatit të tij. Faqja Web e komisionit do të mundësojë përfshirjen e çdo kontributi të mundshëm qytetar e profesional, në përmirësimin e analizës, identifikimin e masave që shërbejnë për ta thelluar këtë proces reformimi dhe përgjithësisht në procesin ligjvënës. Në hapësirën “*Konsultim me publikun*” janë krijuar rubrika të veçanta për të pyetur ekspertët apo anëtarët e komisionit, për të zhvilluar anketime të ndryshme dhe veçanërisht për konsultimin e çështjeve e nismave ligjore që do të dalin gjatë procesit të reformës.

## **Kryetari i Komisionit të Posaçëm takime me ambasadorët e Francës, Suedisë dhe me ekspertë të misioneve dhe projekteve të asistencës të BE-së e SHBA-ve**

Gjatë muajit shtator, kryetari dhe disa nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit, kanë zhvilluar takime me përfaqësues të rëndësishëm ndërkombëtarë, për t'i njohur ata me punën e komisionit dhe objektivat e tij dhe për të ndërtuar bashkëpunimin e nevojshëm me ta. Ambasadorët e Francës dhe Suedisë konfirmuan mbështetjen për këtë iniciativë të Kuvendit dhe për integrimin e Shqipërisë në BE. Ata theksuan rëndësinë e gjithëpërfshirjes në proces si dhe u angazhuan për të ofruar kontributin e vendeve të tyre për fusha specifike të projektit. Po ashtu, ekspertë të misioneve të asistencës e projekteve të BE-së e SHBA-ve të atashuar pranë Komisionit të Posaçëm në disa takime të vecanta të zhvilluar me ta vlerësuan qasjen dhe metodologjinë e punës së komisionit dhe diskutuan për bashkërendimin e punës për monitorimin dhe asistencën që do të ofrohet prej tyre.

### **Komisioni i Posaçëm Parlamentar**



## **KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR**

**“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,  
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR  
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**